

DOKUMENT PËR POLITIKA

DEBATA NACIONALË

PËR REFORMAT ZGJEDHORE


NË MAQEDONINË E VERIUT:

REFORMAT ZGJEDHORE

PËRMES PRIZMIT TË

PERCEPTIMEVE QYTETARE

SHTATOR, 2022





# PËRMBAJTJA

4

## 1. Hyrje

6

## 2. Përmbledhje e Analizës së gjetjeve kërkimore dhe Diskutimit

7

2.1. Numri i njësive zgjedhore

11

2.2. Llojet e listave për kandidatët për deputetë

13

2.3. Votimi jashtë vendit

16

2.4. Regjistrimi i votuesve

19

## 3. Konkluzione dhe rekomandime

21

## Referencat

# 1.

## HYRJE

Zgjedhjet e lira dhe të drejta janë themeli i shoqërisë demokratike, ku interesat e qytetarëve përfaqësohen dhe jepet llogari për to. Maqedonia e Veriut ka pësuar shumë cikle reformash zgjedhore që nga pavarësia e saj, megjithatë ato kryhen më shpesh në prag të zgjedhjeve të radhës, duke kufizuar hapësirën dhe kohën për një debat publik gjithëpërfshirës dhe transparent. Duke synuar të kapërcejë hendekun e dialogut të copëzuar dhe jo-përfshirës mbi reformat zgjedhore, Instituti i Politikave Evropiane zhvilloi Debatin Kombëtar mbi Reformat Zgjedhore në maj dhe qershor 2022, për të hedhur dritë mbi rezultatet e mundshme të ndryshimeve në modelin zgjedhor që janë diskutuar nga partitë politike dhe aktorët e politikës në vend.

### SONDAZHI FILLESTAR

N = 1000 qytetarë

65% maqedonas

25% shqiptarë

10% bashkësi të tjera etnike

### DEBAT DELIBERATIV

4-5 qershor 2022

129 pjesëmarrës

### SONDAZH PAS DEBATIT

N = 129 pjesëmarrës

82,8% maqedonas

15,5% shqiptarë

2,3% bashkësi të tjera etnike

Debati Kombëtar u organizua duke ndjekur metodën e sondazhit dliberativ, të zhvilluar në Qendrën për Demokraci Deliberative në Universitetin e Stanfordit. Sondazhi deliberativ është një formë unike e konsultimit politik që kombinon teknikat e anketimit dhe diskutimit publik, ku pjesëmarrësit anketohen mbi çështjet e synuara para dhe pas përfshirjes në dialog me ekspertë dhe figura politike.<sup>1</sup> Ndryshimet në opinion para dhe pas debatit pasqyrojnë preferencat e qytetarëve, nëse ata do të kishin mundësi të informoheshin më shumë dhe të angazhoheshin më shumë në çështjen(et). Qëllimi kryesor i Debatit Kombëtar ishte rritja e përfshirjes së qytetarëve në reformën e ardhshme të sistemit zgjedhor, nëpërmjet një dialogu gjithëpërfshirës, objektiv me ekspertët përkatës dhe vendimmarrësit.

<sup>1</sup> Shiko <https://cdd.stanford.edu/what-is-deliberative-polling/>.



Debati rezultoi me ndryshime statistikisht të rëndësishme në disa nga opinionet e qytetarëve për reformat zgjedhore, veçanërisht në lidhje me numrin e njësive zgjedhore dhe llojet e listave për deputetë.

Institucionet shtetërore duhet të përfshijnë rregullisht publikun më të gjerë në dialogun e politikave për reformat zgjedhore.

Nevojiten fushata të mëtejshme edukuese dhe informuese për të gjitha reformat (potencialisht të miratuara) zgjedhore.

Sondazhi fillestar u krye në maj dhe përfshinte pyetje rreth njohurive dhe opinionëve/qëndrimeve. Përpara ngjarjes, pjesëmarrësit u pajisën me materiale informuese të balancuara, të shqyrtuara nga ekspertët përkatës për të siguruar informacion të paanshëm dhe objektiv, i cili shërbeu si bazë për diskutimet me ekspertët dhe figurat politike. Pas ngjarjes, pjesëmarrësve iu bë i njëjti sondazh, për të matur ndryshimet në perceptimet e tyre mbi temat e diskutuara. Rezultatet e të dy sondazheve u analizuan duke përdorur testin ANOVA të variancës, për të kontrolluar çdo dallim statistikisht të rëndësishëm në mendimet e qytetarëve para dhe pas ngjarjes deliberative.

Ndërsa ka shumë aspekte të sistemeve zgjedhore dhe modeleve të ndryshme zgjedhore në të gjithë botën, për shkak të kufizimeve kohore, Debati Kombëtar për Reformat Zgjedhore u përqendrua në zgjedhjet parlamentare, duke mbuluar katër tema: (1) numri i njësive zgjedhore, (2) llojet e listave, (3) votimi jashtë vendit dhe (4) regjistrimi i votuesve. Tema e parë mbulonte dy skenarë të mundshëm reformash: i gjithë territori i vendit është një njësi zgjedhore ose status quo – vendi mbetet i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore. Tema e dytë mbulonte listat e hapura apo të mbyllura për kandidatët për deputetë. Tema e tretë mbulonte tre skenarë: status quo – jo-rezidentët votojnë dhe zgjedhin deri në tre deputetë, jo-rezidentët votojnë dhe zgjedhin një deputet dhe jo-rezidentët nuk votojnë fare. Së fundi, tema e fundit mbuloi dy skenarë: regjistrimin aktiv dhe pasiv të votuesve.

Në vijim, kjo përmbledhje e politikave përshkruan dhe diskuton gjetjet kryesore për secilën nga temat e diskutuara në Debatin Kombëtar, dhe paraqet rekomandimet e politikave për palët përkatëse të interesit.



# 2.

## PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SË GJETJEVE KËRKIMORE DHE DISKUTIMIT


Një nga qëllimet kryesore të metodës së sondazhit është të shihet nëse ekspozimi i qytetarëve ndaj debatit të paanshëm dhe të gjerë mbi një temë të veçantë mund të kontribuojë drejt ndryshimeve në perceptimet e tyre. Përveç shqyrtimit të temave specifike, ky Debat Kombëtar u fokusua edhe në mendimin e qytetarëve për zgjedhjet në përgjithësi. Rezultatet treguan se perceptimet/opinionet e tyre ndaj zgjedhjeve në përgjithësi mbetën të qëndrueshme. Me fjalë të tjera, nuk pati ndryshime statistikisht të rëndësishme në opinionin e qytetarëve për disa pyetje të përgjithshme në lidhje me zgjedhjet dhe reformat zgjedhore, pavarësisht se ato u ekspozuan ndaj informacioneve të rëndësishme, si me shkrim ashtu edhe përmes diskutimit publik me ekspertë dhe figura politike përkatëse.

*Qytetarët kanë perceptime pothuajse neutrale (as pozitive, as negative) rreth zgjedhjeve në përgjithësi dhe ata konsiderojnë se përfshirja e publikut të gjerë në debatin publik për reformat zgjedhore është e rëndësishme dhe e nevojshme. Qytetarët gjithashtu janë të qëndrueshëm në mendimin e tyre se reformat*

*zgjedhore deri më tani kanë qenë disi të pasuksesshme dhe ata e konsiderojnë zbatimin e reformave zgjedhore pak para zgjedhjeve disi të papranueshme. Kjo e fundit gjithashtu nuk konsiderohet një praktikë e mirë sipas standardeve ndërkombëtare, pasi reforma para-*

*zgjedhore "ndikon në zbatimin zbatimin e ligjit në kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme",<sup>2</sup> e cila, në afat të gjatë, mund të sjellë mosbesim të mëtejshëm në sistem. Pavarësisht nga kjo, qytetarët mendojnë se reformat shtesë duhet të zbatohen në mënyrë mjaft urgjente - në shkallën nga 0-10 ku 0 ishte aspak urgjente dhe 10 ishte sa më urgjente të jetë e mundur, rezultati mesatar ishte 7.7 para debatit dhe 7.8 pas debatit). Së fundmi, ata në përgjithësi as nuk pajtohen, as nuk kundërshtojnë që të gjithë qytetarët të përfaqësohen në mënyrë adekuate në Kuvend.*

**NË SHKALLË NGA 0 DERI NË 10, A MENDONI SE NEVOJITET NJË PËRFSHIRJE MË E GJERË E PUBLIKUT NË DIALOGUN PËR REFORMAT ZGJEDHORE?**



2 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2011). Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 5 qershor 2011. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR (pp.1). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.



Megjithëse çështjet dhe qëndrimet e përmendura më lart nuk u diskutuan në detaje gjatë debatit, qëndrueshmëria në mendimin e qytetarëve mund të jetë një tregues se ka vërtet nevojë për një debat të gjerë dhe gjithëpërfshirës publik. Qytetarët e zakonshëm, jeta e të cilëve do të ndikohet ndjeshëm nga proceset zgjedhore dhe rezultatet duhet të informohen siç duhet mbi pasojat e sistemeve zgjedhore në lidhje me parimet e përfaqësimit (gjeografik, ideologjik, gjinor, pakicë), inkluzivitetit, ndershmërisë dhe barazisë të votave dhe çështje të tjera të lidhura me rëndësi për politikëbërjen dhe qeverisjen në përgjithësi.

## 2.1. Numri i njësive zgjedhore

Numri i njësive zgjedhore, si dhe madhësia e tyre (nëse janë më shumë në numër) janë ndër variablat kryesorë për t'u marrë në konsideratë gjatë hartimit të një sistemi zgjedhor, duke qenë se ai mund të ndikojë në masë të madhe në shpërndarjen e mandateve, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për shoqëritë e ndryshme të fragmentuara në linja të ndryshme të ndarjeve. Diskutimet mbi këtë temë u fokusuan në dy skenarë reformash: (1) status quo-ja mbetet dhe vendi vazhdon të jetë i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore dhe (2) një njësi zgjedhore në të gjithë territorin e vendit.

Që nga viti 2002, sistemi zgjedhor parlamentar në Maqedoninë e Veriut është proporcional, me lista të mbyllura kandidatësh. 120 deputetë zgjidhen në gjashtë njësi zgjedhore - 20 deputetë nga çdo njësi zgjedhore - dhe rezultatet llogariten duke përdorur formulën d'Hondt. Deri në tre deputetë shtesë zgjidhen përmes votimit jashtë vendit,<sup>3</sup> në një njësi zgjedhore.<sup>4</sup> Gjatë vitit të kaluar, diskutimet për transformimin e gjashtë njësive ekzistuese në një njësi zgjedhore janë intensifikuar, prandaj kjo ishte një nga temat e zgjedhura për këtë Debat Kombëtar.

<sup>3</sup> Që nga viti 2011

<sup>4</sup> Që nga viti 2015

**Qytetarët ishin të qëndrueshëm në mbështetjen e tyre për një njësi zgjedhore në të gjithë territorin e vendit, dhe pas debatit ata kanë tendencë të bien dakord që duhet të ketë gjithashtu një prag të përcaktuar të votave minimale që partitë duhet të fitojnë një vend deputeti**





Megjithëse kjo mund të konsiderohet një reformë e madhe zgjedhore, debati ndikoi në opinionin e qytetarëve vetëm për tre çështje që lidhen me numrin e njësive zgjedhore. Pavarësisht nga debati, ata bien dakord që duhet të ketë një njësi zgjedhore në vend, pas debatit ka pasur një ndryshim statistikisht të rëndësishëm (f-value = 9.41; p-value < 0.01) në mendimin e pjesëmarrësve se përveç pasjes së një njësia zgjedhore duhet të ketë një prag prej minimumi votash që partitë duhet të fitojnë një mandat deputeti. Përkatesisht, ndërsa opinioni i pjesëmarrësve para debatit përqendrohej rreth pozicionit neutral, vlera mesatare pas debatit anonte drejt rënies dakord mbi nevojën për një prag minimal. Kjo mund të sinjalizojë dy gjëra të rëndësishme. Së pari, do të ishte me rëndësi të madhe që Qeveria të sigurojë edukim të duhur të votuesve se pse nevojitet një prag minimal, si vendoset minimumi dhe si përkthehen votat në mandate në një njësi zgjedhore. Së dyti, bazuar në argumentet e paraqitura nga pjesëmarrësit para debatit dhe gjatë diskutimeve, një mbështetje më e fortë për këtë model mund të jetë tregues i faktit se qytetarët janë në favor të më shumë partive që hyjnë në Kuvend, duke minimizuar rrezikun e bllokimeve në punën e tij, për të siguruar funksionimin efektiv.

Një nga argumentet kryesore teorike kundër një njësie zgjedhore është se ky sistem mund të çojë në përfaqësim më të dobët territorial dhe lidhje më të dobët votues-përfaqësues, ndërsa njësit e shumta zgjedhore përmirësojnë llogaridhënien e përfaqësuesve ndaj votuesve, debati rezultoi me mendim kontradiktor për këtë qëndrim. Në kundërshtim me këtë, me një ndryshim statistikisht të rëndësishëm (f-value = 8.8; p-value < 0.01), *ndërsa qytetarët para debatit kishin një pozicion disi neutral ndaj këtij qëndrimi, qytetarët pas debatit kryesisht nuk pajtoheshin se gjashtë njësi zgjedhore përmirësojnë llogaridhënien e përfaqësuesve ndaj votuesve.* Kjo diferencë mund të tregojë mungesën e informacionit dhe njohurive të qytetarëve për këtë çështje.

Nëse e lidhim konstatimin e mësipërm me rritjen e mundësisë së partive të vogla për të hyrë në Parlament sipas sistemit të një njësie zgjedhore, duket e qartë që qytetarët do të ndiheshin më të përfaqësuar nëse partia më e vogël për të cilën kanë votuar do të ishte në gjendje të hynte në Parlament pa pasur nevojë të bënte koalicion me disa nga partitë më të mëdha.

Në rastin e fundit, siç tregon përvoja, vendimmarrja mund të çojë në një ujdi se kush merr çfarë, kështu që në rast të një njësie zgjedhore, në një skenar ideal, partia e tyre do të jetë në gjendje të fitojë një mandat në Parlament dhe të punojë për të përfaqësuar elektoratin e tyre jashtë një koalicioni, ndërsa elektorati mund t'i mbajë ata përgjegjës në bazë të asaj që përfaqësuesi/et e tyre bëjnë për ta. Megjithatë në realitet, këto dinamika janë të ndryshme.





Këto gjetje mund të tregojnë se ndërsa në teori mbajtësit e listës zakonisht janë politikanë që gëzojnë mbështetje në njësinë zgjedhore ku ata kandidojnë për zgjedhje dhe votuesit mund të identifikohen me ta dhe të formojnë një lidhje më të ngushtë, në praktikë mund të mos jetë kështu dhe ajo që mbizotëron në fund është votimi për një parti sesa për një kandidat, pavarësisht nga numri i njësive zgjedhore. Në shkallën përfundimtare, duke pasur parasysh numrin e njësive zgjedhore që mund të ndikojnë në pjesën e vendeve midis partive në Parlament, qytetarët duhet të informohen siç duhet se çfarë do të thotë një njësi zgjedhore, cilat janë përfitimet dhe të metat e saj dhe si do të ndikojë kjo tek votuesit.

Ndryshime statistikisht të rëndësishme ( $f$ -value = 13.5;  $p$ -value < 0.001) në opinione ndodhën gjithashtu në qëndrimin se *gjashtë njësi zgjedhore kontribuojnë në një koalicion qeveritar më të qëndrueshëm – ndërsa qytetarët para debatit kishin një mendim mjaft neutral për këtë çështje, pas debatit ata anuan drejt mospajtimit me qëndrimin..* Ngjashëm me qëndrimin e mëparshëm, ky qëndrim shkon në kundërshtim me postulatet teorike, të cilat mund të tregojnë se qytetarët konstatojnë se Qeveria mund të ruajë stabilitetin edhe pse Kuvendi do të ketë përfaqësues nga më shumë parti politike.

NJË NJËSI ZGJEDHORE DO TË REZULTOJË  
NË NJË POLARIZIM MË TË VOGËL TË  
KULTURËS POLITIKE MES PARTIVE MË  
TË MËDHA NË VEND



6.04

6.69

Nëse shohim mendimin e tyre se si një njësi zgjedhore do të ndikojë në polarizimin e kulturës politike midis partive më të mëdha politike, gjetjet e mësipërme nuk do të habisin. Nëse perceptimi është se një njësi zgjedhore do të ulë polarizimin midis partive më të mëdha politike, atëherë duket se qytetarët do të prisnin që kjo do të forconte kulturën e bashkëpunimit, në vend që të kontribuonte në grindje të mëtejshme. Në të njëjtën kohë, mund të ndodhë që qytetarët më mirë të shohin partinë e tyre të preferuar të përfaqësuar në Parlament, sesa të mendojnë se çfarë i bën kjo stabilitetin të Qeverisë në përgjithësi. Ndoshta kjo mund të shpjegohet me faktin se partitë në Maqedoninë e Veriut shpesh formojnë (ose bashkohen) një koalicion paszgjedhor, kështu që qytetarët nuk besojnë se numri i njësive zgjedhore do të ndikojë ndjeshëm në stabilitetin e koalicionit Qeveritar (i cili mund të formohet ose zgjerohet shpesh) me më shumë parti politike paszgjedhore.






Debati Kombëtar nuk kontribuoi në ndryshime statistikisht të rëndësishme në mendimet e qytetarëve për çështjet e tjera të diskutuara (Tabela 1).

Tabela 1: Opinione lidhur me numrin e njësive zgjedhore që nuk u ndryshuan ndjeshëm pas debatit

Në lidhje me reformat zgjedhore, në shkallë prej 0 deri në 10, ku 0 është aspak nuk pajtohem, kurse 10 është plotësisht pajtohem, sa pajtoheni me çdonjë prej reformave në vijim



## 2.2. Llojet e listave për kandidatët për deputetë

Sistemi proporcional i listave është një nga dy llojet më të popullarizuara të sistemeve zgjedhore të përfaqësimit proporcional. Në Maqedoninë e Veriut, listat e kandidatëve u futën në 2002, me kalimin e sistemit zgjedhor nga maxhoritar në proporcional dhe ato kanë qenë çdoherë të llojit të mbyllur. Partitë politike dhe ekspertët kanë diskutuar mundësinë e futjes së listave të hapura, megjithatë diskursi publik ka qenë shumë i kufizuar me informacionin dhe reforma nuk është vënë kurrë me të vërtetë në tryezë deri kohët e fundit, kur listat e hapura u bënë një nga fushat e mundshme në paketën e fundit të paralajmëruar të reformës zgjedhore. Pavarësisht kësaj, ka pasur pak ose aspak informacion mbi llojet e preferuara të partive politike për listat e hapura dhe as se si kjo do të ndikojë në ndarjen e mandateve në Kuvend.

Në varësi të llojit të listës/votimit, sistemet me listë të hapur ndryshojnë në 'nivelin e hapjes', dhe nuk ka model të përshtatshëm për të gjithë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh kufizimet e këtij sondazhi reflektues, opsionet e reformës të diskutuara nuk hynë në detaje në lidhje me llojin e listave të hapura, duke pasur parasysh se pikat e forta dhe të dobëta të tyre janë të njëjta,<sup>5</sup> Pjesëmarrësit u informuan gjithashtu se lloji më i zakonshëm i listave të hapura janë ato ku votuesit mund të japin vetëm nga një deri në tre vota preferenciale për kandidatët, pra votuesit nuk mund të votojnë për aq kandidatë sa ka vende deputetësh për të mbushur në njësinë zgjedhore.

Futja e listave të hapura në një vend mund të konsiderohet një reformë e madhe zgjedhore dhe duke ditur kompleksitetin e tyre, kjo kërkon edukim të rëndësishëm të votuesve, veçanërisht duke marrë parasysh se kjo temë, së bashku me reformat në njësitë zgjedhore kanë qenë dy temat 'më të nxehta' në diskursin publik. Interesant është fakti se pavarësisht ekspozimit ndaj materialeve gjithëpërfshirëse të leximit dhe diskutimit me ekspertët dhe politikanët përkatës, Debati Kombëtar nuk kontribuoi në dallime statistikisht të rëndësishme në opinionin e qytetarëve për çështjen e llojeve të listave dhe pikëpamjet e tyre mbetën të pandryshuara pas debatit (Tabela 2).

5 International Foundation for Electoral Systems (2009) Proportional Representation Open List Electoral Systems in Europe. Election Issues, Paper 1.


**Gjetjet e këtij Debati Kombëtar sinjalizojnë se qytetarët janë kryesisht në favor të prezantimit të listave të hapura. Qytetarët mbështesin një sistem zgjedhor që kontribuon drejt zvogëlimit të centralizimit të partisë dhe fuqisë së liderëve të partive, si dhe që inkurajon deputetët e zgjedhur të ndihen më të përgjegjshëm ndaj elektoratit të tyre, duke forcuar kështu llogaridhënien dhe cilësinë e degës ligjvënëse**





Tabela 2: Opinione lidhur me llojet e listës së kandidatëve për deputetë që nuk ishin ndryshuar ndjeshëm pas debatit

Në lidhje me reformat zgjedhore, në shkallë prej 0 deri në 10, ku 0 është aspak nuk pajtohem, kurse 10 është plotësisht pajtohem, sa pajtoheni me çdonjë prej reformave në vijim



Megjithëse qytetarët priren të bien disi dakord se partitë politike tashmë propozojnë kandidatë për deputetë që njihen në njësitë zgjedhore ku ata kandidojnë, ata bien dakord më fort se votuesit duhet të kenë mundësi të votojnë për kandidatë të veçantë, që siç argumenton Teoria e Afërsisë,<sup>6</sup> shpjegohet me faktin se votuesit kërkojnë kandidatë që janë ideologjikisht pranë pozicioneve të tyre.

Në tërësi, gjetjet e këtij Debatit Kombëtar sinjalizojnë se qytetarët janë kryesisht në favor të futjes së listave të hapura, edhe pse teorikisht kjo mund të shkaktojë konflikt brenda partisë për shkak të konkurrencës në rritje midis kandidatëve nga e njëjta parti politike. Duke marrë në konsideratë të gjitha argumentet e paraqitura në favor të sistemeve me lista të hapura, rezultatet e debatit kombëtar tregojnë se qytetarët mbështesin një sistem zgjedhor që kontribuon drejt reduktimit të centralizimit të partisë dhe fuqisë së drejtuesve të partisë dhe që inkurajon deputetët e zgjedhur të ndihen më të përgjegjshëm ndaj elektoratit të tyre, duke forcuar kështu përgjegjshmërinë dhe cilësinë e degës legislative.

<sup>6</sup> Shih Downs, 1957



Siç u përmend më parë, ekzistojnë opsione dhe lloje të shumta të sistemeve me lista të hapura. Prandaj, përfshirja e publikut më të gjerë në dialogun e reformës është e rëndësishme, duke i përgatitur ata për atë që duhet të prësin varësisht nga lloji i listave të hapura që do të përzgjidhen nga politikëbërësit. Edukimi adekuat i votuesve do të jetë gjithashtu i rëndësishëm, për të zbutur rreziqet e fletëvotimeve të pavlefshme për shkak të “votimit të gabuar” nga votuesit që nuk u informuan siç duhet se si të shprehin preferencën e tyre në një votim me listë të hapur.

### 2.3. Votimi jashtë vendit

Të drejtat e votës në shoqëritë demokratike janë thelbi i të drejtave politike të njerëzve, megjithatë votimi nga jashtë mbetet një pyetje mjaft përçarëse, veçanërisht në lidhje me atë se çfarë sistemi zgjedhor duhet të zbatohet, si duhet të organizohet kjo, kush duhet të ketë të drejtë të votojë, cilat duhet të jenë modalitetet e votimit. Ndërsa sigurimi i të drejtës së votës për jorezidentët konsiderohet praktikë evropiane që e kanë miratuar të gjitha vendet anëtare të BE-së, ka vende në botë që nuk organizojnë votim jashtë vendit. Në përgjithësi, rreth 73% e shteteve dhe territoreve në botë kishin miratuar një formë të votimit jashtë vendit deri në vitin 2020.<sup>7</sup>

Në Maqedoninë e Veriut, votimi jashtë vendit u prezantua për herë të parë në vitin 2011, në tre njësi zgjedhore,<sup>8</sup> të shkruara në një në vitin 2015, ku deri në tre deputetë zgjidhen sipas sistemit proporcional. Në qoftë se regjistrohen votues të mjaftueshëm për të votuar dhe bëhen zgjedhje, zgjedhja e këtyre deputetëve është e kushtëzuar nga fitimi i numrit minimal të votave që nevojiten për të fituar një mandat në një nga gjashtë njësitë zgjedhore brenda vendit.

7 International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2007), *Voting from Abroad: The International IDEA Handbook*, International IDEA

8 Njësia Zgjedhore 7 – Evropa dhe Afrika, Njësia Zgjedhore 8 – Amerika e Veriut dhe e Jugut, dhe Njësia Zgjedhore 9 – Australia dhe Azia.





**Qytetarët janë përgjithësisht në favor të ofrimit të jorezidentëve të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar jashtë vendit. Megjithatë, ata konstatojnë se mund të bëhen reforma në këtë fushë – para së gjithash në uljen e numrit maksimal të deputetëve që mund të zgjidhen për të përfaqësuar diasporën.**

E drejta e votës është një e drejtë e garantuar me kushtetutë për çdo qytetar të Maqedonisë së Veriut, kështu që debati nëse jorezidentët duhet të votojnë jashtë vendit ose jo është mjaft i ndjeshëm, duke pasur parasysh se marrëdhënia e tyre me shtetin ndryshon kur ata largohen nga territori i vendit të tyre, veçanërisht për një periudhë të zgjatur kohore.<sup>9</sup> Për shkak të modaliteteve të ndryshme të kryerjes së votimit jashtë vendit dhe duke pasur parasysh përvojën e mëparshme në Maqedoninë e Veriut me votimin jashtë vendit, për qëllimet e kësaj ngjarjeje të votimit të diskutueshëm u paraqitën tre opsione: (1) një status quo, domethënë jorezidentët mund të votojnë në një njësi zgjedhore dhe të zgjedhin deri në tre deputetë; (2) jorezidentët mund të votojnë në një njësi zgjedhore dhe të zgjedhin një deputet; dhe (3) nuk ka votim jashtë vendit fare.

Debati Kombëtar rezultoi me një ndryshim statistikisht të rëndësishëm të opinionëve vetëm në dy çështje lidhur me votimin jashtë vendit. Përkatësisht, me 99% siguri (f-value = 7.08; p-value = 0.01), konstatoam se ndërsa para debatit qytetarët deri diku ranë dakord se heqja e të drejtës së jo-rezidentëve për të votuar do të shkaktojë shfaqjen e linjave të reja të ndarjes midis qytetarëve (vlera mesatare 5.9), pas debatit ata deri diku nuk u pajtuan me këtë (vlera mesatare ra në 4.7). Nëse ky ndryshim i perceptimeve u shkaktua nga ekspozimi i tyre ndaj informacionit mbi rënien e numrit të njerëzve që regjistrohen për të votuar jashtë vendit gjatë viteve kërkon hulumtime shtesë, por megjithatë ky konstatim është interesant, duke marrë parasysh se bazohet në opinionin e votuesve brenda vendit.


Ndryshimi i dytë statistikisht i rëndësishëm (f-value = 4.46; p-value < 0.05) në opinionet pas debatit i referohet numrit të deputetëve që janë të mjaftueshëm për të përfaqësuar të gjithë diasporën. Para debatit, qytetarët ishin pothuajse neutral për atë se një deputet ishte i mjaftueshëm për të përfaqësuar të gjithë diasporën (vlera mesatare 4.97), ndërsa pas debatit disi u pajtuan me këtë pretendimin (vlera mesatare u rrit në 5.9). Duke pasur parasysh materialet që pjesëmarrësit morën para debatit dhe diskutimin gjatë debatit, kjo tregon se ata janë disi dakord që një deputet do të mjaftonte për të përfaqësuar të gjithë diasporën. Në lidhje me këtë, pavarësisht se pas debatit nuk u vunë re ndryshime të rëndësishme statistikore, vlen të përmendet se qytetarët deri diku nuk janë dakord mbi mbajtjen e status quo-së – që votuesit jashtë vendit të zgjedhin deri në tre deputetë.

<sup>9</sup> Collyer, Michael and Vathi, Zana (2007) Patterns of Extra-territorial Voting (working paper). Development Research Centre on Migration, Globalization and Poverty.



Duke marrë parasysh konsistencën në opinione për pjesën tjetër të pyetjeve mbi këtë temë të mbuluar me sondazh (Tabela 3), del në pah se qytetarët në përgjithësi janë në favor të ofrimit të së drejtës së tyre kushtetuese për të votuar jashtë vendit nga ana e jorezidentëve, por konstatojnë se reformat mund të bëhen në këtë fushë – para së gjithash në uljen e numrit maksimal të deputetëve që mund të zgjidhen për të përfaqësuar diasporën.

Tabela 3: Opinione në lidhje me votimin jashtë vendit që nuk u ndryshuan ndjeshëm pas debatit





## 2.4. Regjistrimi i votuesve

Sipas legjislacionit aktual, regjistrimi i votuesve brenda vendit në Maqedoninë e Veriut është pasiv, domethënë të gjithë votuesit me të drejtë vote janë regjistruar në Listën zgjedhore përmes kontrollit të kryqëzuar të grupeve përkatëse të të dhënave nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor.

Pavarësisht nga debati, duke pasur parasysh se si qytetarët mbetën në opinionet e tyre para dhe pas debatit, duket se ata nuk kanë ndonjë preferencë kur bëhet fjalë për regjistrimin e votuesve, që mund të jetë për shkak të mungesës së informacionit mbi temën në diskutimin publik.

Lista zgjedhore përmban të gjithë shtetasit e vendit që kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve dhe që janë banorë të vendit. Jo-rezidentët që duan të votojnë jashtë vendit duhet të vetë-regjistrohen për ta bërë këtë, domethënë ka regjistrim aktiv. Lista e veçantë e votuesve është përgatitur për shtetasit që banojnë përkohësisht në një vend të huaj për qëllime pune apo studimi që kanë një qëndrim të vlefshëm në territorin e Maqedonisë së Veriut, të cilët nuk janë regjistruar për të votuar në një Zyrë Diplomatike-Konsullore (ZDK). Shtetasit që janë të punësuar përkohësisht ose banojnë jashtë vendit gjatë zgjedhjeve dhe janë regjistruar për votim jashtë vendit në ZDK-të ose zyrat konsullore nuk do të përfshihen në Listën zgjedhore që përdoret për votim në Maqedoninë e Veriut.<sup>10</sup>

Për qëllime të Debatit Kombëtar, dy opsione reforme u paraqitën për votimin në vend: (1) votuesit duhet të regjistrohen për të votuar (regjistrimi aktiv), dhe (2) status quo - Lista zgjedhore është përgatitur nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (regjistrimi pasiv). Edhe pse ka mënyra të ndryshme për të organizuar regjistrimin aktiv të votuesve, duke ditur se vendi tashmë përdor një sistem të caktuar për regjistrimin aktiv të votuesve për votimin jashtë vendit, pika fillestare për diskutimet ishte se i njëjti sistem mund të aplikohet në zgjedhjet në vend, ose të modifikohet sipas mundësive dhe burimeve në dispozicion (teknike, financiare, etj.)

Ndryshime të rëndësishme statistikore u vunë re në dy çështje. *Para debatit, qytetarët ranë dakord më shumë se rritja e TI-së e bën më të lehtë projektimin e një sistemi mirë-funksionues për regjistrimin online të votuesve, sesa bënë pas debatit* ((vlerat e tjera shkuan nga 8.2 në 7.3; f-value = 5.98,

<sup>10</sup> „Службен весник на Република Македонија”, бр. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 и „Службен весник на Република Северна Македонија”, бр. 98/19, 42/20, 74/21 и 215/21.





p-value = 0.01), që është interesante duke pasur parasysh se pothuajse gjysma e pjesëmarrësve i përkasin grupmoshes 30-49 vjeç, një grup që mund të konsiderohet digjitalisht i edukuar dhe përdorues i shpeshtë i mjeteve dhe platformave dixhitale. Për më tepër, pavarësisht nga fakti se në teori, regjistrimi aktiv i votuesve duhet të kontribuojë në një listë më të mirë dhe më të saktë të votuesve, *qytetarët pas debatit ishin pothuajse neutralë në këtë qëndrim (vlera mesatare 5.8), krahasuar me para debatit, kur ata u pajtuan deri diku (vlera e nënkuptuar 6.9) kjo do të ndodhë me të vërtetë (f-value = 6.88; p-value = 0.01).*

Ndërsa sot është me të vërtetë më e lehtë të projektohet një sistem online që funksionon mirë për regjistrimin e votuesve, nuk ka garanci se sistemi nuk do të abuzohet dhe nuk është e sigurt se ky sistem do të kontribuojë në më pak parregullsi në Listën zgjedhore. Megjithatë, bazuar në prirjet e vëzhguara, duket se besimi në institucionet është ende i ulët dhe kërkohet më shumë punë dhe edukim i votuesve me qëllim që të rritet aftësia e përdorimit të TI-së si dhe të institucioneve që e përdorin atë. Një gjë tjetër për t'u konsideruar është frika se regjistrimi i detyrueshëm i votuesve mund të pengojë pjesëmarrjen politike të personave me paaftësi në qoftë se procedurat e regjistrimit të votimit janë të paaksesueshme.


Ajo që vlen të diskutohet janë gjithashtu çështjet ku nuk u vunë re dallime statistikisht të rëndësishme pas debatit (Tabela 4). Në përgjithësi, gjendja e përgjithëshme e qytetarëve është disi neutrale kur vjen puna te regjistrimi aktiv i detyrueshëm me qëllim që të jenë në gjendje të votojnë ditën e zgjedhjeve. Shtetasit janë deri diku dakord se besimi në zgjedhje do të jetë më i lartë nëse regjistrimi aktiv është i detyrueshëm, por janë më të prirur të bien dakord se regjistrimi pasiv ka më shumë gjasa të sigurojë regjistrimin e të gjithë votuesve me të drejtë vote. Më së fundi, ata bien dakord më shumë, se duhet të ketë fushatë edukuese mbi regjistrimin e votuesve në qoftë se regjistrimi aktiv i votuesve futet në Maqedoninë e Veriut.





Tabela 4: Opinione lidhur me regjistrimin e votuesve që nuk janë ndryshuar ndjeshëm pas debatit

Në lidhje me reformat zgjedhore, në shkallë prej 0 deri në 10, ku 0 është aspak nuk pajtohem, kurse 10 është plotësisht pajtohem, sa pajtoheni me çdonjë prej reformave në vijim



Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se **shtetasit nuk janë kundër idesë së regjistrimit aktiv të votuesve me qëllim që të jenë në gjendje të votojnë ditën e zgjedhjeve**. Megjithatë, nëse kjo futet, duke marrë parasysh të gjitha përfitimet që mund të sjellë, institucionet përkatëse duhet të sigurojnë fushata përmbajtore dhe gjithëpërfshirëse të edukimit të votuesve, të cilat jo vetëm do të shpjegojnë se si duhet bërë regjistrimi aktiv, por edhe për të siguruar informacion të mjaftueshëm rreth mënyrës se si funksionon sistemi i përdorur, kush ka një mbikëqyrje mbi të dhe cilat janë përfitimet e regjistrimit aktiv, si në afat të shkurtër, ashtu edhe në afat të gjatë.



# 3. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Ka shumë sisteme dhe modele të ndryshme zgjedhore dhe nuk ka një mënyrë të drejtë për të zbatuar zgjedhjet, duke pasur parasysh se sistemet e ndryshme zgjedhore kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre dhe ndikojnë shumë në kuadrin më të gjerë politik dhe institucional.<sup>11</sup> Çfardo sistemi që zgjedh një vend, është e rëndësishme që ai të sigurojë zgjedhje të lira dhe të rregullta, duke pasqyruar shoqërinë dhe interesat e elektoratit, si dhe të sigurojë përfaqësimin e duhur të të gjitha grupeve. Një debat publik gjithpërfshirës dhe transparent mbi reformat zgjedhore është më se i nevojshëm, për të parandaluar reformat që nxiten vetëm nga interesat e partive politike dhe grupeve elitare, interesat e të cilave prirën të forcohen rreth sistemit zgjedhor ekzistues.

Ky Debat Kombëtar mbi Reformat Zgjedhore kontribuoi në kapërcimin e hendekur të dialogut të fragmentuar dhe jo-përfshirës mbi reformat zgjedhore, dhe në informimin e mëtejshëm të publikut se pse duhen disa reforma ose si do të ndikojnë ato në procesin zgjedhor dhe rezultatet e zgjedhjeve. Diskutimi dy-ditor ofroi një debat të gjallë dhe shkëmbim të frytshëm informacioni e opinionit midis ekspertëve dhe politikanëve nga njëra anë dhe shtetasve nga ana tjetër. Megjithë dallimet e rëndësishme në disa qëndrime përpara dhe pas debatit, ka patur qëndrime ku shtetasit mbeten të qëndrueshëm në opinionin e tyre. Kjo nuk duhet të interpretohet as si dekurajuese, as si një ngjarje jo efektive, por si një thirrje për rritje urgjente të përfshirjes së qytetarëve në dialogun mbi reformat zgjedhore dhe ndoshta më e rëndësishmja, ajo duhet të tregojë nevojën për fushata të menjëhershme edukimi. Bazuar në gjetjet, më poshtë janë dhënë rekomandimet tona për politikëbërësit në lidhje me reformat zgjedhore që duhet shtyrë përpara.

## REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME:

1. Ministria e Drejtësisë, si aktori politik në këtë fushë, duhet të përfshijë rregullisht publikun më të gjerë në dialogun e politikës mbi reformat zgjedhore.
2. Komisioni Shtetëror Zgjedhor duhet të sigurojë përgatitjen dhe përhapjen e materialeve që synojnë edukimin e votuesve mbi të gjitha reformat zgjedhore (potencialisht të miratuara), duke përfshirë numrin e njësisve zgjedhore, listat e hapura, regjistrimin e votuesve.

<sup>11</sup> International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2005) Electoral System Design: Overview of the New International IDEA Handbook, International IDEA





### NËSE KA NDRYSHIME NË NUMRIN E NJËSIVE ZGJEDHORE:

1. Institucionet shtetërore duhet të sigurojnë që votuesit të informohen siç duhet se çfarë do të thotë futja e një njësie zgjedhore, se cilat janë përfitimet dhe të metat e saj dhe si do të ndikojë kjo tek votuesit

### NËSE FUTEN LISTAT E HAPURA PËR KANDIDATËT PËR DEPUTETË:

1. Institucionet shtetërore duhet të përgatisin dhe të nxisin shpërndarjen e informacionit të posaçëm e të hollësishëm mbi tipin e vendosur të listave të hapura.
2. Liderët e partive duhet të shfrytëzojnë rastin për të nxitur listat e hapura anembanë partisë së tyre dhe të inkurajojnë konkurrencën e shëndetshme midis kandidatëve të mundshëm, me qëllim që të zbusin konfliktet brenda-partiake.
3. Komisioni Shtetëror Zgjedhor duhet të përgatisë dhe t'u sigurojë qytetarëve materialet arsimore mbi votimin me lista të hapura, për të pakësuar rreziqet e fletëvotimeve të pavlefshme për shkak të «votimit të gabuar» nga votuesit që nuk u informuan siç duhet mbi mënyrën e të shprehurit të preferencës së tyre në një listë të hapur votimi.

### MBI REFORMAT POTENCIALE NË VOTIMIN JASHTË VENDIT:

1. Institucionet shtetërore mund të shqyrtojnë mundësinë e hapjes së një debati mbi numrin e deputetëve të zgjedhur nga votimi jashtë vendit.

### NËSE PARAQITET REGJISTRIMI AKTIV I VOTUESVE:

1. Në mënyrë që të shmangen nivelet e larta të mosbesimit në sistemin elektronik për regjistrimin aktiv të votuesve, institucionet përkatëse duhet të japin informacion për publikun se si funksionon sistemi, kush e mbikqyr atë, dhe cilat janë përfitimet e regjistrimit aktiv, si në afat të shkurtër, ashtu edhe në afat të gjatë
2. Institucionet shtetërore duhet të parashikojnë dhe krijojnë mekanizma të posaçëm për të parandaluar abuzimin dhe përdorimin e pahijshëm të sistemit potencial elektronik për regjistrim aktiv të votuesve nga partitë politike.
3. Institucionet shtetërore duhet të hartojnë sistemin për regjistrimin aktiv të votuesve në një mënyrë që është përfshirëse dhe jo diskriminuese për çdo grup specifik demografik, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.
4. Komisioni Shtetëror Zgjedhor duhet të përgatisë dhe shpërndajë fushata përmbajtëse dhe gjithëpërfshirëse të edukimit të votuesve me informacion të rëndësishëm dhe të hollësishëm se si të regjistrohen për votim.



# REFERENCAT

1. Collyer, M. and Vathi, Z. (2007). *Patterns of Extra-territorial Voting* (working paper). Development Research Centre on Migration, Globalization and Poverty.
2. Downs, A. (1957). *An economic Theory of Democracy*. New York.
3. International Foundation for Electoral Systems. (2009). *Proportional Representation Open List Electoral Systems in Europe*. Election Issues, Paper 1.
4. International Institute for Democracy and Electoral Assistance. (2007). *Voting from Abroad: The International IDEA Handbook*, International IDEA.
5. International Institute for Democracy and Electoral Assistance. (2005). *Electoral System Design: Overview of the New International IDEA Handbook*, International IDEA.
6. Organization for Security and Co-operation in Europe Office of Democratic Institutions and Human Rights. (2011). *Early Parliamentary Elections 5 June 2011. OSCE/ODIHR Election Observation Mission Final Report* (pp. 1). Organization for Security and Co-operation in Europe.





 EPI.Skopje

 epi\_mk

 [www.epi.org.mk](http://www.epi.org.mk)